



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Ven. nr. 01 / 2189 Dt. 03 / 11 / 2022

Në mbështetje të nenit 15 paragrafi 15 dhe 16 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademike në UKZ, Senati në mbledhjen e XXXVII të radhës të mbajtur më datë 27.10.2022, mori:

**V E N D I M**

1. Refuzohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike që të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent Lindita Loku.
2. I kthehet për rishqyrtim Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike raporti i Komisionit Recensues.

**Arsyetim**

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjilan, në mbledhjen e XXXVII të mbajtur më 27.10.2022, ka vendosur që ta përsërisë procedurën e votimit për zgjedhjen e një mësimdhënësi në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, pasi që në mbledhjen e XXXVI asnjëri nga rezultatet e votave nuk e kishte arrite shumicën e votave të anëtarëve të senatit dhe ky votim duhet të përsëritet.

Sekretari i Përgjithshëm, pas kërkesë së dekanit të FSHK lidhur me procedurën e votimit për këtë rast, ka kërkuar nga ana e Sekretarit që të bëjë një interpretim.

Sekretarit i Përgjithshëm e ka bërë interpretimin dhe ka kërkuar përsëritjen e votimit pasi asnjëri nga rezultatet nuk kishte arrite shumicën e votave të anëtarëve të senatit.

Pas përsëritje së procesit të votimit me shumicë të votave të anëtarëve të Senatit, refuzohet propozimi i Këshillit të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike që të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent Lindita Loku.

Duhet të theksohet se Këshilli i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kishte propozuar që Lindita Loku të zgjidhet në thirrjen akademike profesor asistent, ndërsa Komisioni i Studimeve e kishte kundërshtuar sepse sipas Komisionit të studimeve kandidatja Lindita Loku nuk e kishte përvojën e mjaftueshme në mësimdhënie universitare, studimet bachellor dhe master i ka në fushën e ekonomisë ndërsa studimet e doktoratës në fushën e shkencave teknike – informatike dhe i mungojnë dy certifikata sipas nenit 10.7 të Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademike në UKZ

Senati e kthen edhe një herë procedurën në Këshill të Fakultetit.



Kryesuesi i Senatit

Prof. Dr. Bajram Kosumi, rektor

Vendimi i dërgohet:

1. Fakultetit të Shkencave Kompjuterike
2. Senatit
3. Arkivit